

URDHER REGJISTRIMI

Me

1. 21.597

2.a. Mikrotajeri, Lore e Sh.A.

b. Lore e

c. Traden Produkti, partit konfereca en e.g. cyje Jakubi Z

c. 140.400.000 leke - zyrtar, eksport uortel, part uortel, gjeam c. t. e. p. m. m. a. z.

3. Drona Pero
Jenci Luome
Hico i re bicka

4. Statuti neishkruar me date 25.5.1999

5. Data 5.7.1999

Statuti 0 Fict.

Njoftime: a shoqeria

b. dhomen e tregtise

c. organit perftates financiar

d. zyres se statistikes

Publikime:

GJYQTARE

AKT -THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijohet shoqerine anonime "Trikotazhi " Korce Sh.A.
2. Objekti i shoqerise eshte:
Prodhim produkti I gatshem konfeksione,thurje zbardhje prerje , qepje, etiketim dhe amballazhim .
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Korce dhe ajo mund te çele dege, filiale agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 140.400.000 i ndare ne 140.400 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
 - Diana PERO
 - Genci LUARASI
 - Kico TREBICKA
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGETARE

URDHER

Nr. 900 Date 26.12.2006

PER

NDRYSHIM NE KESHILLIN MBIKEQYRES

Mbështetur ne Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995, "Për transformimin e Ndërmarrjeve Shtetërore ne Shoqëri Tregtare", i ndryshuar, si dhe ne Vendimin e Këshillit te Ministrave Nr 642, date 11.10.2005, "Për Këshillat Mbiqëqyrës te Shoqërive Anonime Shtetërore,

URDHEROJ :

1. Lirimim nga detyra te anëtarit te Këshillit Mbiqëqyrës te " Trikotazhi" Sh.A. Korçe,
- Zj. Diana PERE
2. Përbërja e Këshillit Mbiqëqyrës te " Trikotazhi" Sh.A. Korçe, te jete si me poshtë:
- Zj. Vjollca BEQIRI Përfaqësuese e METE-s.
- Zj. Mamica DHAMO Përfaqësuese e METE-s.
- Z. Aljan VOKOPOLA Përfaqësues i METE-s.
3. Ne zbatim te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", nenet 24 dhe 33, te bëhen ndryshimet përkatëse ne Regjistrin Tregtar te Gjykatës se Rrethit Tirane.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



Tirane, me _____ 2007

VENDIM

Nr.7, dt. 02.02.2007

Per

Lirim nga detyra te Drejtorit te "Trikotazhi Korçe" Sh.a.

Keshilli Mbikqyres i "Trikotazhi Korçe" Sh.a., i mbledhur sot me 01.02.2007, ne prezence te plote te anetareve te tij, në zbatim të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", neni 98, per ti dhene nje ritem te ri aktivitetit te kesaj shoqerie

VENDOSI:

Znj. Zamira Kacorri, deri tani Drejtore e "Trikotazhi Korçe" Sh.a., te lirohet nga kjo detyre.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

VJOLLCA BEQIRAJ

MAMICA DHAMO

Anetare



ALIAN VOKOPOLA

Anetar



Nr. _____ Prot.

Tirane, me 05.02.2007

VENDIM

Nr.8, dt. 05.02.2007

Per

Emerimin ne detyren e Drejtorit te "Trikotazhi Korçe" Sh.a.

Keshilli Mbikqyres i "Trikotazhi Korçe" Sh.a., i mbledhur sot me 02.02.2007, ne prezence te plote te anetareve te tij, në zbatim të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", neni 97, per ti dhene nje ritem te ri aktivitetit te kesaj shoqerie

VENDOSI:

Emerimin e Znj. Eva DHAMO, ne pozicionin Drejtore e "Trikotazhi Korçe" Sh.a.Korçe.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

VJOLLCA BEQIRAJ

MAMICA DHAMO

Anetare



ALIAN VOKOPOLA

Anetar



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Trikotazhi Korçe Sh.a.
Keshilli Mbikqyres

Nr. 2 Prot.

Tirane, me 23/01/2008

VENDIM

Nr.2, dt. 23.01.2008

Per

Emerimin ne detyren e Drejtorit te "Trikotazhi Korçe" Sh.a.

Keshilli Mbikqyres i "Trikotazhi Korçe" Sh.a., i mbledhur sot me 23.01.2008, ne prezence te plote te anetareve te tij, në zbatim të ligjit Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", neni 97

VENDOSI:

1. Emerimin e Z. Leon Qako, ne pozicionin Drejtor i "Trikotazhi Korçe" Sh.a.Korçe.
2. Paga e drejtorit do te jete 40 000 leke.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETAR

VJOLLCA BEQIRAJ

MAMICA DHAMO

Anetare

ALIAN VOKOPOLA

Anetar



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGUTISË DHE SIPËRMARKES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 7357 Datë 28. P. 2015

PËR

LIRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË "TRIKOTAZHI" KORÇË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 991, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Urdhrit të MZHETTS Nr. 43, datë 20.10.2014 "Për bashkimin me përthithje të sh.a "Trikotazhi" Korçë nga sh.a "Këpuca" Korçë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Trikotazhi" Korçë;

URDHËROJ:

1. Lirimini e Z. Leon QAKO, nga detyra e Administratorit të shoqërisë "Trikotazhi" sh.a Korçë.
2. Marrëdhëniet financiare rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
4. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGUTISË DHE SIPËRMARKES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 7357 Datë 28. P. 2015

PËR

EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE "KËPUCA" SH.A KORÇË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 991, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe Urdhrit Nr. 448, datë 20.10.2014 "Për bashkimin me përthithje të "Trikotazhi" sh.a Korçë nga "Këpuca" sh.a Korçë, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërive "Trikotazhi" sh.a Korçë dhe "Këpuca" sh.a Korçë;

URDHËROJ:

1. Emërimin e Z. Ilia JATAGANI, në detyrën e Administratorit të shoqërisë përthithëse "Këpuca" sh.a Korçë.
2. Z. Ilia JATAGANI, aktualisht administrator i shoqërisë "Këpuca" Korçë, do të jetë edhe Administrator i sh.a "Trikotazhi" Korçë, deri në përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje të sh.a "Trikotazhi" nga "Këpuca" sh.a Korçë.
3. Shoqëria e re krijuar nga bashkimi do të quhet "Këpuca" Korçë.
4. Në zbatim të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32,36, të bëhen ndryshimet përkatëse në regjistër.
5. Ngarkohet Drejtoria e shoqërisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

